



**UNIVERSITETI I MITROVICËS**  
**UNIVERSITY OF MITROVICA**  
**"ISA BOLETINI"**

PIM Trepça, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës  
Tel: +381-28535725/535727

Rektor i UMIB-it  
Prof. asoc. dr. Alush Musaj

Nr. Prot. 546/004  
Dt 14.04.2017

Në bazë të nenit 48, pika 1.3, të Statutit të Përkohshëm, Senati i Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini", në mbledhjen e mbajtur më 13.4.2017, mori:

**VENDIM**

- I. Refuzohet si e pabazë ankesa e Arsim Rashitit me nr. prot. 133 të datës 02.02.2017, e paraqitur kundër raportit të Komisionit recensues për mospërzgjedhjen e tij, në bazë të konkursit të shpallur më 31.10.2016 të Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini".
- II. Vërtetohet në tërësi vendimi i Senatit me nr. prot. 60/004, i datës 20.01.2017, për përzgjedhjen e kandidatës Leonora Çarkaj në pozitën "Një asistent për lëndët: Bazat e shkencave natyrore me metodologji I, Bazat e shkencave natyrore me metodologji II, Edukimi mjedisor, në Fakultetin e Edukimit të Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini".

**Arsyetim**

Universiteti i Mitrovicës ka shpallur konkurs për zgjedhjen e një asistenti për lëndët: Bazat e shkencave natyrore me metodologji I, Bazat e shkencave natyrore me metodologji II, Edukimi mjedisor, në Fakultetin e Edukimit të Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini".

Pas shpalljes së buletinit nr. 9 në ueb-faqen zyrtare të UMIB-it, ankimuesi Arsim Rashiti ka paraqitur ankesë me nr. prot. 133 të datës 02.02.2017, me të cilin pretendon se i është bërë shkelje nga ana e komisionit recensues, i cili nuk ka shkruar raport për ankimuesin.

Senati i Universitetit, në mbledhjen e mbajtur më 13.4.2017, duke pasur parasysh propozimin e Komisionit për ankesa dhe parashtresa, konstatoi se propozimi i Komisionit recensues është në pajtim të plotë me nenin 153, pika 5 dhe nenin 159 të Statutit të UMIB-it, për arsye se kandidati është më i vjetër se 30 vjet (neni 159, pika 1.2) dhe Komisioni vlerësues bën vlerësimin e kandidatëve të cilët konsiderohen që kanë përmbushur kushtet për postin e ofruar (neni 153, pika 5). Në bazë të kësaj që u tha më sipër, Senati vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes në dorëzim, MASHT-it.

Vendimi t'i dërgohet:

1. Arkivit të UMIB-it;
2. Të përmendurit;
3. Fakultetit;
4. Zyrtarit ligjor.



Prof. asoc. dr. Alush Musaj

Rektor i UMIB-it